

Fundi i Botesâ Â

Kontribuar nga Dr.Shefqet Krasniqi
Monday, 15 February 2010

Sa është largësia e njohurisë që e arrijnë shqisat dhe a janë ato në gjendje ta kuptojnë krejt çka ekziston? Ç`është imagjinata? A ka kufij ajo, apo është e lirë?

(vijon nga artikulli i javës së kaluar)

Javën e kaluar cekëm disa fakte për ata të cilët i thonë vetës "materialistë", duke besuar vetëm në atë që mund të perceptohet me shqisa, për të treguar se edhe ata medoemos besojnë në gjëra që dalin jashtë shqisave. Ndër ato fakte të cilat i sollëm ishte se njeriu mund t`i perceptojë gjërat nëpërmjet shqisave duke u ardhur në ndihmë atyre edhe mendja, mirëpo besojmë edhe në gjëra të tjera, të cilat nuk janë të pranishme para nesh, por ato i kemi arritur nëpërmjet lajmeve të sigurta, bile këtu janë edhe më shumë sesa ato që i perceptojmë me shqisa.

Andaj erdhëm në përfundim se, ashtu siç arrihet te bindja e fortë nëpërmes shqisave dhe vështrimit, po ashtu arrihet edhe nëpërmjet dëshmimeve të transmetuesve. E vazhdojmë edhe sot për t`i sjellë disa fakte të tjera bindëse, për të besuar në gjëra të fshehta:

Sa është largësia e njohurisë që e arrijnë shqisat dhe a janë ato në gjendje ta kuptojnë krejt atë që ekziston? Apo thënë ndryshe: a ka mundur ndonjëra nga shqisat ta zbulojë gjithë atë që gjendet në botë mbi të cilën ka vigjiluar?

P.sh. nëse dalim në natyrë dhe vështrojmë gjithë atë që gjendet para nesh, sa larg sheh syri ynë?! Pastaj në mes asaj që sheh syri ynë ka edhe shumë gjëra të cilat, edhe pse ekzistojnë, ai megjithatë nuk i sheh, p.sh tek një largësi prej njëqind metrash mund të ketë buburreca, apo insekte të tjera, më të mëdhenj apo më të vegjël, por ne nuk i shohim, pastaj ai buburrec apo ai insekt sigurisht se ka zë, por ne atë nuk e dëgjojmë, por patjetër se dikush edhe e sheh atë buburrec edhe ia dëgjon zërin. Ose marrim gotën me ujë dhe ne në të nuk vërejmë tjetër pos ujit të rëndomtë, ani pse aty brenda në gotë ka me miliona mikroorganizma të cilët qarkullojnë e lëvizin.

Vendosim mjaltin në kuzhinë e cila ka aromën e vet, por ne nuk e ndiejmë atë ndërsa buburreci ia ndien erën, për atë edhe i ofrohet atij mjalti. Po ashtu ndodh edhe me aromën e sheqerit. Bile edhe më qartë se kaq, jemi në dhomë duke ndenjur në një qetësi të plotë, fare zëra nuk dëgjojmë. Për një çaste ngrihesh në këmbë dhe hap radion, ku tashmë ndien zëra të ndryshëm. Zëra këta të cilët kanë qenë edhe më herët nëpërmjet valëve të ndryshme, por ja që ti nuk i ke dëgjuar, por në realitet ata kanë ekzistuar. Pra vijmë në përfundim se shumë gjëra nuk hynë në sferën e shqisave apo ndjenjave, ani pse ato ekzistojnë dhe ne besojmë thellë në ekzistimin e tyre.

Allahu i Madhëruar për t`iu ndihmuar shqisave dhe për t`i plotësuar ato ka krijuar imagjinatën, ashtu që falë kësaj dhuntie të Allahut njeriu mund ta perceptojë një objekt të cilin e ka parë më herët, por tash nuk e ka para syve të tij. p.sh ai i cili ka qenë në Mekë dhe ka parë Qabën e shenjtë, sa herë që do mund ta parafytyrojë dhe ta përshkruajë Qabënë, iu duket sikurse është duke e parë tani. Po ashtu ndodh edhe me ndonjë zë që e kemi dëgjuar më herët. Mirëpo, a thua imagjinata është e kufizuar apo e lirë? Thënë ndryshe, a mund të parafytyrojë diç që nuk e kam ndier me shqisa?! Kemi dy lloje imagjinatash. Imagjinata konstruktive është ajo që është ndërtuar më herët, është imagjinatë reale, siç thamë të perceptuarit e Qabesë, dhe imagjinata destruktive, e cila është joreale, ku njeriu imagjinon diçka çka është jashtë shqisave të tij. p.sh thotë Allahu i Madhëruar: "Nëse të pyesin ty për shpirtin, thuaju: ajo është që i takon Zotit tënd, ndërsa juve u është dhënë fort pak dituri" (Kuran, 17:85) Shtrohet pyetja, si do ta imagjinonte njeriu shpirtin kur as nuk e ka parë e as nuk e ka dëgjuar, as aromën nuk ia ka ndier e as nuk e ka prekur?! Ose si do t`i imagjinonte njeriu melaqet - engjëjt, kur ai nuk i ka parë asnjëherë?! Kur kam fjalën te melaqet, më kujtohet kur isha i vogël, disa ashkali i sillnin disa vizatime, kinse Ibrahim i a.s duke dashur ta therte birin e tij Ismailin, e në anën tjetër zbriste një melaqe nga qielli me një dash në dorë, për t`ia dhënë Ibrahimit si kompensim në vend të birit të tij që ta therë kurban. Ibrahim ishte i vizatuar në formë të një plaku me mjekër të bardhë, e Ismaili si një djalosh i ri.

Deri këtu ta zëmë se ishte në rregull, ngase ashtu edhe mund të imagjinohen ata dy babë e bir, edhe pse artisti i cili i ka vizatuar nuk i ka parë, por a thua si e ka imagjinuar melaqen të cilën nuk e ka parë kurrë?! E ka bërë në formë të një vajze të re, të bukur, me fustan të gjatë dhe me krahë. A thua ashtu është melaqja?! Asnjëherë. Por kjo është ajo imagjinata destruktive, e cila del jashtë shqisave dhe asnjëherë njeriu nuk është në gjendje ta imagjinojë ashtu siç ekziston, apo siç është reale.

Të njëjtën gjë e hasim edhe me imagjinatën e djallit të mallkuar. Nga kjo themi si ta imagjinojmë xhenetin dhe të mirat e tij, xhehenemin dhe vuajtjet në të?! Si mund ta imagjinojmë njërin apo tjetrin, kur ajo që është në atë botë është krejt ndryshe nga ajo çka kemi në këtë botë?! Pra përfundimisht themi se edhe shqisat edhe mendja e edhe imagjinata janë të kufizuara. Kaq sa për sot, e inshallah javën tjetër vazhdojmë po me të njëjtën temë.

Deri atëherë selam alejkum ve rahmetullah!

Sa është ne gjendje mendja te gjykoje? A ka kufij ajo mendje? A ka njerëz vërtet ateiste, apo edhe ata ndonjëherë kthehen ne fe?

Ne dy artikujt e mëparshëm thamë se njeriu vjen deri te njohja e gjerave nëpërmjet shqisave duke ju ardhur ne ndihme atyre, natyrisht, mendja, dhe se këto shqisa janë te mangëta. Pastaj njeriu ka imagjinatën, e cila shume u ndihmon shqisave dhe, sikur mos te ishte ajo imagjinate, njeriu do te ishte tepër i mangët, mirëpo edhe kjo imagjinate, ashtu si shqisat dhe mendja, është e kufizuar. Këto ishin faktet te cilat u munduam ne pika te shkurtra t`i sqarojmë gjate dy artikujve te dy javëve te kaluara. Por, te shkojmë edhe me tej për te sjelle fakte te tjera bindëse për te besuar ne gjera te fshehta.

Kemi cekur me herët se mendja gjykon atë qe vigjilojnë shqisat se a e kane mire apo keq. P.sh kur syri sheh magjistarin se si po nxjerr nga faculeta e tij dhjetëra lepuj, ajo ndërhyr e thotë: kjo është e pavërtete dhe se neve vetëm syri po na

mashton, përndryshe është e pamundur të dale nga faculeta lepuri. Mirëpo, a thua sa është në gjendje mendja ta gjykojë? A ka kufij ajo mendje? Mendja mund të kuptojë e të gjykojë vetëm atë që është brenda kohës dhe hapësirës, përndryshe ajo çka del jashtë këtyre dy faktorëve ajo nuk është në gjendje në mënyrë absolute që ta perceptojë e të gjykojë për të. P.sh nëse vjen një plak i odave dhe na thotë se dikur kanë qene dy persona shume të mëdhenj, Mujo dhe Halili, saqë stalla e kuajve të tyre ka qene sa një shtëpi e sotme tre katesh, mirëpo ata nuk kanë qene as në kohën e turkut, e as para turkut, as në kohën e ilireve e as para tyre, e as pas tyre, por ajo çka është e sigurt është se ata kanë qene. Mendja këtë nuk do të mund ta kuptojë asnjëherë, sepse e kërkon kohën se kur kanë qene ata. Ose nëse dikush thotë se: ekziston një qytet i bukur, mahnitës, mirëpo ai nuk është as në tokë e as në qiell. A do të pajtohej mendja me këtë?! a do të jete në gjendje ta perceptojë atë të dhënë e cila nuk lidhet as me vend e as me hapësirë?! Asnjëherë?! Nëse është kështu atëherë themi: si është në gjendje mendja e njeriut ta perceptojë Lartmadhërinë e Allahut apo cilësitë e Tij, ta gjykojë Atë, kurse Ai është jashtë hapësirës?! Natyrisht se nuk ka mundësi, ashtu siç nuk ka mundësi ta perceptojë e ta kuptojë çështjen e shpirtit, çështjen e jetës pas vdekjes e kështu me radhe.

Te gjithë njerëzit, pa dallim a janë besimtare apo ateiste, që te gjithë kur janë në zor të madh, kthehen tek Allahu i Madhëruar dhe kërkojnë nga Ai ndihmë. Kur njeriun ta kape ndonjë frikë e madhe si lufta, apo sëmundje e rende nga e cila pak shpreson në shërim, pasi gati sa i ka humbur shpresat nga njerëzit, ai vetvetiu instinktivisht kthehet dhe kërkon ndihmë nga një fuqi e madhe të cilën nuk e ka parë, por e ka ndier thellë në zemrën e tij. Nuk ka kush që me bind mua se Enveri e Titoja nuk e kanë ndjere në shpirtin e tyre një fuqi të madhe të cilës iu kanë drejtuar, se paku kur kanë qene në hall të madh, apo kur e kanë ndier afër vdekjes, por para njerëzve e kanë fshehur atë sepse haptazi e kanë kundërshtuar. Këta dy "ateiste" nuk kanë qene të rangut të Faraonit, i cili ka jetuar në kohën e Musait, e i cili jo vetëm që mohonte Zotin, por e konsideronte veten si zot. Megjithatë, kur i erdhi vdekja - që u fundos në det - tha: "Besova se nuk ka zot tjetër pos Atij që i besuan Beni Israilet (Musa me popullin e tij)" (Junus: 90), por natyrisht se ishte tepër vonë për të, ashtu siç u bë vonë për Enverin dhe Titon dhe për shume ateiste të tjerë pas dhe para tyre. Kam lexuar diku se e bija e Stalinit ka botuar "kujtimet e saj" dhe aty kishte cekur se si ajo i është kthyer fesë me gjithë faktin se ajo është rritur në djep të ateizmit. Pra, çdo njeri i mire apo i keq, besimtar apo ateist, në shpirtin e tij thellë e ndjen një nevojë për të besuar në diçka të madhe, për t'iu drejtuar asaj fuqie të madhe se paku kur është në zor të madh, e që në realitet ajo është e mbjelle në zemrën e tij, në natyrshmërinë e tij, e që në e quajmë atë besim apo fe. Shpesh me kujtohen shqiptaret tanë gjatë luftës si "refugjate" neper Shqipëri e Maqedoni, se si u ndjenin shume afër Zotit dhe thuajse te gjithë kur flisje për fe te dëgjonin me vëmendje, ndërsa pas përfundimit të luftës dhe kthimit të tyre në shtëpitë e tyre, pasi nuk kishte më frikë, sikurse filluan ta konsiderojnë veten të panevojshëm për fe. Pra, jo rrallëherë ndodh që ky njeri të kthehet me dashje a padashur në natyrshmërinë e tij në të cilën është i lindur me të. Andaj, nëse do të thuash apo të konstatosh nga ky kontekst se nuk ka njeri ateist, mund të thuash dhe nuk gabon fare. Por ajo çka ndodh me njerëzit është se këtë natyrshmëri njerëzore ndonjëherë e mbulojnë epshet, dëshirat, pasionet, interesi i madh i dynjasë, e pastaj kur ta tronditin atë tmerret, rreziqet e hedh nga vetja atë mbulesë dhe paraqitet besimi. Për atë arsye, në Islam, ai i cili e mohon Allahun quhet "kafir/qafir", e që në i themi mosbesimtar, apo jomysliman. Por, kuptimi i ngushtë i kësaj fjale është: ta mbulosh diçka, ta mbulosh realitetin e ekzistimit të Allahut, ta mbulosh ndjenjën e tij të brendshme për ekzistimin e Allahut - Krijues i gjithësisë.

Nga kjo themi se është e pamundur që njeriu të jetojë e të vdesë pa menduar në Zotin e kësaj gjithësie, mirëpo ai mund të jete mendjeshkurtër e mos të arrijë ta njohë Zotin e vërtetë, për çka mund të adhurojë gjera të tjera duke menduar se ka adhuruar apo i është drejtuar Zotit të vërtetë, ashtu siç ka mundësi shume here që familja dhe shoqëria të janë shkaktare që ai person mos ta gjejë rrugën e vërtetë.

Kaq sa për këtë jave. Deri javën e ardhshme, selam alejkum ve rahmetullah!